



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi _ dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit nga parashtruesi nga, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në seancën e 47 të mbajtur me datë 31.03.2021 morri

VENDIM

Procedura për lëndën numër 12-4936 nga viti 2019, e formuar pas denoncimit nr. 12-4936/1 me datë 22.10.2019 dorëzuar nga pparashtruesi nga NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën me numër 12-4936 nga viti 2019.

Lënda me numër 12-4936 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin,

Vendimi i KSHPK me sqarimin në formë të depersonalizuar të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej pesë ditë nga dita e marrjes së vendimit.

SQARIM

Lënda me numër 12-4936 nga viti 2019 është e formuar në bazë të denoncimit nr. 12.4936/1 me datë 22.10.2019 dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtruesi nga

Në denoncim flitet për akuza kundër Ministrisë për punë dhe politikë sociale dhe Qendrës për punë sociale, përshkak të ndërprejes së të ardhurave të parashtruesit në bazë të ndihmës sociale të cila ai e ka fituar si ndihmë në të holla përshkak të gjendje së mjerueshme ekonomike në të cilën gjendet ai dhe familja e tij.

Gjatë shqyrtimit të rastit KSHPK i merr parasyshë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri tek Ministria për punë dhe politikë sociale për dorëzim të të dhënave dhe informacioneve në lidhje me rastin e lëndës. Pas kërkesës së Komisionit shtetëror janë dorëzuar informime dhe pas shqyrtimit të dokumenatcionit të plotë për rastin e lëndës nga ana e KSHPK u vërtetuar gjendja faktike vijuese:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për familje katërantarëshe nga, të cilëve prindit u janë pa punë dhe kanë dy fëmij të mitur, dhe të cilës përshkak të gjendjes së mjerueshme ekonomike iu është pagur ndihmë sociale nga ana e Ministrisë për punë dhe politikë sociale. Këto të ardhura iu janë ndërprerë përshkak se personi që të mirëmbanë familje e tij ka mbledhur shishe plastike dhe me ato të holla që i ka tubuar në këtë bazë si shfrytëzues i ndihmës sociale sipas ministrisë, ka tejkalar limitin i cilia ka qenë i lejuar për këtë lloj të pagesës dhe i është ndërprerë ndihma sociale. Përndryshe parashtruesi ka qenë i punësuar dhe ka punuar 18 vite në fabrikë, mirëpo nga mbyllja e saj ai ka qenë shfrytëzues i ndihmës sociale nga Ministria për punë dhe politikë sociale. Nga

ana e parashtruesit është dorëzuar kërkesë deri tek Ministria për punë dhe politikë sociale dhe Qendra për punë sociale që t'i prëgjigjen se për çfarë arsye i është ndërprerë kjo ndihmë dhe nga ato si organe kompetente ka kërkuar që t'i ndihmojnë për zgjidhje të gjendjes në të cilën gjendet familja e tij, mirëpo institucionet sikur mos të kenë veshë për kërkesën e tij. Në denoncimin e dorëzuar nuk ka arsye të sakta se prej kur personi është shfrytëzues i ndihmës sociale dhe kur saktë i është ndërprerë ndihma sociale.

- Pas kontrollimeve të bëra, është konstatuar se para ditës së parashtrimit të denoncimit në KSHPK në medime ka pasur publikim për rastin e lëndës, me datë 17 dhe 19.10.2019, në lidhje me akuzat e njëjta të parashtruesit të denoncimit si dhe bashkëshortja e tij ka qenë në gjendje shëndetësore kritike në Kliniklën e nefrologjisë, ai nuk ka pasur mjete që ta bëjnë pagesën e participimit, prandaj ka qenë i detyruar publikisht të drejtohet për nevojën e tij, përshkak të moskujdesit të institucioneve. Gjithshtu ka pasur publikim edhe me 17.08.2013 për atë se familja e nga në vitin 2013 i ka ndodhur edhe një tragjedi e madhe gjegjësisht iu është djegur shtëpia familjare në të cilën kanë banuar, kurse për zjarrin parashtruesi ka qenë i bindur se iu është bërë me qëllim.
- Me datë 28.02.2020, me kërkesë të KSHPK, nga ana e Sektorit për mbrojtje sociale pranë Ministrisë për punë dhe politikë sociale është dorëzuar përgjigje me të cilën informojnë se personi ka qenë shfrytëzues i ndihmës sociale deri me datë 01.10.2018, kur nga ana e IP QPS i është dhënë aktvendim për ndërprerje të shfrytëzimit të të drejtës për ndihmë sociale në të holla nr. përshkak të mosparaqitjes së të ardhurave mbi limitin e lejuar prej 30.000 denarë në përputhje me nenin 2 paragrafi 2 nga Rregullorja për mënyrën e përcaktimit të gjendjes së të ardhurave, pronës dhe të drejtën e pronës së amvisërisë, përcaktimit të bartësit të të drejtës dhe dokumentacioni i nevojshëm për realizimin dhe shfrytëzimin e të drejtës së ndihmës sociale në të holla (Gazeta zyrtare e RM, nr. 54/13, 126/13, 11/15, 25/15, 77/15, 163/16 dhe 72/18). Kundër aktvendimit të qendrës i emërtuari ka parashtruar ankesë deri tek Ministria për punë dhe politikë sociale e cila nga ana e ministrisë i është rrefuzuar si e pa bazë kurse aktvendimi i IP QPS është vërtetuar me aktvendim me datë 22.11.2018.

Në lajmërimin informohet dhe se me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit të ri për Mbrojtje sociale (Gazeta zyrtare e RM, nr. 104/19, 149/19 dhe 275/19) personi ka dorëzuar kërkesë për realizim të të drejtës për ndihmë minimale të garantuar me datë 13.11.2019 dhe e njëjta i është rrefuzuar me Aktvendim për rrefuzim të kërkesës për realizim të të drejtës për ndihmë minimale të garantuar me datë 09.01.2020 përshkak të mosdorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm (*letërnjoftim valid, aktgjykim për shkurorzim, deklaratë me shkrim nga parashtruesi dhe anëtarët tjerë të familjes për përdorim të të dhënave personale në procedurë dhe pëlqim me shkrim që të zbulohen të dhënat e tyre depozitive në të gjitha bankat dhe shtëpi-kursimesh në Republikën e Maqedonisë së Veriut*). Edhe pse personi dhe me shkrimë shtë informuar dhe është obliguar me Lajmërim me datë 17.12.2019 që ta kompletin dokumentacionin e nevojshëm. Në fund informohet se të emërtuarit nga ana e IP QPS me aktvendim me datë 30.01.2020 i është dhënë ndihmë të njëhershme prej 7000 denarë e cila i është paguar gjatë muajit shkurt të vitit 2020.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, KSHPK konstaton se në rastin e lëndës bëhet fjalë për zgjidhje të çështjes e cila nuk është në kompetenca për veprim të KSHPK, dhe njëherit për rastin është vepruar nga ana e organit tjetër i cili është kompetent të vepron – Ministria për punë dhe politikë sociale, e cila ka vepruar pas kërkesës së parashtruesit të denoncimit të dorëzuar me datë 13.11.2019, gjegjësisht pas kërkesës e cila është dorëzuar pas datës së dorëzimit të denoncimit në KSHPK, mirëpo e njëta i është rrefuzuar nga ana e ministrisë përshkak se mosveprimi të tij, nuk ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm edhe pse parashtruesi është informuar dhe obliguar me lajmërim me datë 17.12.2019 ta kompletonte dokumentacionin e nevojshëm. Duke pasë parasyshë të konstatuarën, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën ndërpritet dhe lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasyshë të shënuarën mësipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimit.

KOMISIONI SHTETËROR ПËР
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT
Kryetarë: Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri tek: Arkiva, Parashtruesi
Pas përfundimit të senacës së KSHPK
Përpunoi: J. C., këshilltarë
Miratoi: m-r Sh. S., anëtarë i KSHPK